



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KUVENDI KOMUNAL ASSEMBLY OF MUNICIPALITY SKUPŠTINA OPŠTINE  
SKENDERAJ

Nr. \_\_\_\_\_  
No. 42-052/07-0062547/26  
Data. \_\_\_\_\_  
Data. 16.01.2026



Komuna Skenderaj  
Opština Skenderaj  
Municipality of Skenderaj

*Drejtoria për Zhvillim Ekonomik Ndërmarrësi Inovacion dhe Turizëm  
Direkcija za Ekonomski Razvoj Preduzetništvo Inovacije i Turizam  
Directorate for Economic Development Entrepreneurship Innovation and Tourism*

## RAPORTI I PUNËS

### DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK NDËRMARRËSI INOVACION DHE TURIZËM (DZHENIT)

*Besarta Meha Ademi  
Drejtoreshë  
Adresa: Rruga 28 Nëntori, Skenderaj  
Email: besarta.meha@rks-gov.net*



**Janar 2026**

Raporti i punës së Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi, Inovacion dhe Turizëm paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara, përkatësisht me planin e punës për vitin 2025, si dhe dokumentet strategjike, si: Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal dhe Strategjia për Zhvillimin e Turizmit, të cilat paraqesin vizionin dhe misionin e komunës.

Gjatë vitit 2025, DZHENIT ka punuar ngushtë me partnerë strategjikë dhe donatorë si UNDP, Water for Life, MZHR, Qatar Charity dhe partnerë të tjerë kombëtarë e ndërkombëtarë.

Bashkëpunimi ka mundësuar realizimin e projekteve kapitale, mbështetjen e grave ndërmarrëse dhe bizneseve të vogla, promovimin e turizmit, si dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të stafit dhe komunitetit.

Ky raport paraqet në tabela për secilën njësi punët dhe aktivitetet e realizuara, duke përfshirë të dhënat e detajuara nga projektet kapitale, grantet për biznese, promovimin e turizmit dhe shërbimet për bizneset.

### Projektet Kapitale:

EMRI I PROJEKTIT	DONATORET	MUAJ/VITI	TE DHËNAT E PROJEKTIT
Projekti i ndërtimit të shëtitorës natyrale dhe krijimi i hapësirave rekreative	Komuna e Skenderajt	2024-2025	Ky projekt ka për qëllim ta bëjë qytetin e Skenderajt më atraktiv për vizitorët dhe banorët. Është rregulluar shëtitorja dhe është ndërtuar shtegu i çiklizmit në parkun "Idriz Rreci".
Vendosja e një Billbordi me Pikat Turistike	Komuna e Skenderajt	2025	Është vendosur një billboard me pika turistike, me qëllim të informimit dhe orientimit të qytetarëve dhe vizitorëve të Skenderajt rreth pikave turistike në Skenderaj.

### - Grante:

GRANTET:	DONATORI:	MUAJ/VITI	TE DHËNAT E GRANTIT:
Programi për OJQ-të Lokale sipas programit Reload	Komuna e Skenderajt	2024-2025	Gjatë vitit paraprak janë përkrahur 12 organizata të shoqërisë civile të cilat realizojnë projekte në fushën e Bizneseve, Inovacionit dhe Turizmit. Projekti ishte vazhdimësi nga viti i kaluar. DZHENIT ka vazhduar me

			monitorim dhe percjelljen e pagesave.
Rregullim të furnizimit me ujë të pijes	Water for Life	2025	Riparimi i rrjetit dhe furnizimi me ujë të pijes për familje të ndryshme dhe paisje të tjera të nevojshme, 40 familje përfituese.
Program i Qendrushmerisë Ekonomike	Komuna e Skenderajt UNDP		Më qellim të krijimit të vendeve të reja të punës dhe ofrimit të kushteve për punë brenda, janë mbështetur 12 biznese.

DZHENIT ka ofruar shërbime për bizneset dhe qytetarët që kanë shprehur interes për hapjen e bizneseve të reja, ndryshimin ose edhe shuarjen e tyre.

Bizneset 2025	Hapja të reja	Ndryshime	Ndërrimi i certifikatave	Shuarje	Numri i të punësuarve të deklaruar nga bizneset e reja
	172	86	48	35	235

Bazuar në rregulloren komunale për taksat, tarifrat dhe gjobat, të miratuar nga Asambleja Komunale, DZHENIT merret edhe me taksën për bizneset, shpërndarjen e tyre, si dhe mbajtjen e evidencës për këtë taksë.

DZHENIT, gjatë vitit 2025, ka realizuar edhe një varg aktivitete:

AKTIVITETET:	MUAJ/VITI	TË DHËNAT E AKTIVITETIT:
Organizimi i dy Panairove për promovimin e produkteve lokale	2025	Ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e produkteve vendore, ndërmarrësisë dhe iniciativave lokale. Aktiviteti është mbajtur me 40 pjesëmarrës në dy panairove.
Qyteti i Mençur(Smart City)	2025-26-27	Është krijuar një platformë digjitale që ofron informacione mbi të gjitha shërbimet e nevojshme, me qëllim përmirësimin e informimit dhe qasjes së qytetarëve dhe vizitorëve të Skenderajt.
Organizimi i ecjeve në shtigje	2025	Janë organizuar ecje në shtigje të ecjes për promovimin e tyre

Janar 2026

Vizita në biznese	2025	Janë vizituar bizneset për t'i parë nga afër nevojat dhe kërkesat e tyre.
Promovimi i komunës dhe rritja e investimeve.	2025	Përgatitja e projekt-propozimeve dhe pjesëmarrja në konferenca me donatorë, si dhe vizita të vazhdueshme tek donatorët..

**Janar 2026**